



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 8157 / 2 Prot.,

Tiranë, më 02. 7.2026

UDHËZIM

Nr. 03, datë 02. 7.2026

“PËR
PROCEDURAT STANDARDE TË FUNKSIONIMIT TË SEKTORIT TË VLERËS
NË QENDËR”

Në zbatim të nenit 10, 47 dhe 51, nenet 65 deri 71 të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neneve 148 deri 169 dhe 737 të Vendimit Nr. 651, datë 10.11.2017 të Këshillit të Ministrave “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 921, datë 29.12.2014 “Për personelin e administratës doganore”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 03, datë 23.01.2018 “Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore”, i ndryshuar,

U D H Ë Z O J:

I. HYRJE

1. Vlerësimi doganor përbën një nga elementët më të rëndësishëm të procedurave doganore, pasi lidhet drejtpërdrejt me përcaktimin e bazës së taksimit të mallrave të importuara dhe garantimin e mbledhjes së drejtë të të ardhurave doganore. Një sistem efektiv i kontrollit të vlerës doganore synon jo vetëm mbrojtjen e interesave fiskale të shtetit, por edhe garantimin e konkurrencës së ndershme midis operatorëve ekonomikë.

2. Ky udhëzim është hartuar për të shërbyer si dokument orientues dhe praktik për strukturat doganore që ushtrojnë funksionet e kontrollit dokumentar, analizës së riskut dhe vlerësimit doganor. Udhëzimi synon standardizimin e praktikave administrative dhe krijimin e një metodologjie të unifikuar pune për doganierët e vlerësimit.

3. Nëpërmjet këtij udhëzimi synohet:

- a) rritja e eficiencës së kontrolleve;
- b) përmirësimi i analizës së riskut;

- c) unifikimi i praktikave të rivlerësimit;
- d) garantimi i transparencës administrative;
- e) të respektohet parimi i mbështetjes së konkurrueshmërisë së kompanive shqiptare;
- f) të respektohet parimi i lehtësimit të mëtejshëm të tregtisë së ligjshme;

4. Kontrolli i vlerës doganore duhet të realizohet gjithmonë mbi bazën e analizës objektive të dokumentacionit, të dhënave financiare, kushteve tregtare dhe elementeve të riskut që lidhen me transaksionin e deklaruar.

II. QËLLIMI I UDHËZIMIT

1. Ky udhëzim ka për qëllim standardizimin e procedurave të kontrollit dokumentar dhe vlerësimit doganor nga strukturat përgjegjëse të administratës doganore.

2. Objektivat kryesore të këtij udhëzimi janë:

- a) garantimi i mbledhjes së drejtë të të ardhurave doganore;
- b) sigurimi i trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë;
- c) parandalimi dhe evidentimi i rasteve të nën/mbivlerësimit;
- d) harmonizimi i praktikave administrative me Marrëveshjen GATT/WTO dhe legjislacionin e Bashkimit Europian;
- e) rritja e eficiencës së kontrollit doganor;
- f) rritja e transparencës së vendimmarrjes.

III. BAZA LIGJORE

1. Procedurat e kontrollit dhe vlerësimit doganor mbështeten në:

- a) Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë;
- b) Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor;
- c) Marrëveshjen për Zbatimin e Nenit VII të GATT 1994;
- d) Udhëzimet e Organizatës Botërore të Doganave (WCO);
- e) Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë.

IV. ORGANIZIMI DHE KOMPETENCAT

1. Sektori Vlerësimit në Qendër, në Drejtorinë e Vlerësimit në Qendër, pjesë e Departamentit Teknik në DPD, është përgjegjës ndër të tjera për zbatimin e legjislacionit doganor në fuqi lidhur me verifikimin dokumentar të të gjitha deklaratave të përzgjedhura automatikisht për këtë sektor nga sistemi Asycuda World, në kanal të verdhë dhe të kuq, në procedurat e zgjeruara, kutia 37/a e DAV:

- a) 4000 (me kodet shtesë 37/b: "000", "IND", "MTD" dhe ato që trajtojnë mallra akcize)

- b) 4071 (me kodet shitesë 37/b: "000", "IND", "MTD" dhe ato që trajtojnë mallra akcize)
- c) 4700 (me kodet shitesë 37/b: "000", "IND", "MTD" dhe ato që trajtojnë mallra akcize)
- d) 4771 (me kodet shitesë 37/b: "000", "IND", "MTD" dhe ato që trajtojnë mallra akcize)
- e) 4053

2. Për të gjitha rastet kur kodet shitesë lidhen me përjashtim të plotë ose të pjesshëm të detyrimeve doganore të importit, deklaratat do të trajtohen nga degët doganore ku është regjistruar deklarata.

3. Sektori Vlerësimit në Qendër është përgjegjës gjithashtu edhe për:

- a) kontrollin dokumentar;
- b) analizën e riskut në vlerësimin doganor;
- c) kërkesat për informacion shitesë;
- d) rivlerësimin doganor;
- e) koordinimin me Degët Doganore dhe strukturat e tjera në DPD;
- f) monitorimin e deklaratave me risk të lartë.

V. PARIMET E VLERËSIMIT DOGANOR

1. Procesi i vlerësimit doganor duhet të mbështetet në parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit, objektivitetit dhe transparencës. Doganieri duhet të analizojë çdo praktikë doganore në mënyrë individuale, duke u mbështetur në dokumentacionin tregtar, financiar dhe transportues të paraqitur nga operatori ekonomik.

2. Vlerësimi doganor konsiston në verifikimin e vlerës së transaksionit, pra çmimit realisht të paguar ose të pagueshëm për mallrat e importuara. Vetëm në rastet kur ekzistojnë dyshime të arsyeshme ose kur kushtet ligjore nuk plotësohen, administrata doganore kalon në përdorimin e metodave alternative të vlerësimit.

3. Çdo vendim rivlerësimi duhet të jetë:

- a) i argumentuar;
- b) i dokumentuar;
- c) i mbështetur në prova objektive;
- d) proporcional me gjetjet e konstatuara;
- e) i komunikueshëm dhe i ankimeshëm.

4. Doganieri duhet të sigurohet që procesi i kontrollit të mos çënojë parimin e sigurisë juridike dhe trajtimin të barabartë të operatorëve ekonomikë.

5. Vlera doganore duhet të pasqyrojë vlerën reale ekonomike të mallrave.

6. Metoda kryesore e vlerësimit është vlera e transaksionit.

7. Metodat alternative aplikohen vetëm sipas rendit hierarkik.

8. Çdo vendim rivlerësimi duhet të jetë i argumentuar dhe i dokumentuar.

VI. METODAT E VLERËSIMIT DOGANOR

1. Metoda bazë e vlerësimit është metoda 1 “Vlera e transaksionit”. Kur vlera doganore e mallrave nuk mund të përcaktohet sipas metodës 1 “Vlera e transaksionit”, ajo përcaktohet me një nga metodat pasardhëse, duke ndjekur rendin rritës dhe zbatuar metodën më të parë, për të cilën ka të dhëna të nevojshme për vlerësimin e mallrave sipas Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 03, datë 23.01.2018 “Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore”, i ndryshuar.

2. **Metoda 1 – Vlera e transaksionit** përdoret kur:

- a) ekziston shitja për eksport;
- b) çmimi është real;
- c) nuk ka kufizime që ndikojnë në vlerë;
- d) marrëdhënia midis palëve nuk ndikon në çmim.

3. Elementë që shtohen në vlerën doganore janë:

- a) transporti;
- b) siguracioni;
- c) komisionet;
- d) leje/licenca;
- e) kostot e paketimit;
- f) kostot e ngarkim-shkarkimit.

3. Nëse nuk zbatohet Metoda 1, duhen argumentuar dhe shënuar në formularin e vlerësimit arsyet në mënyrë të detajuar dhe shteruese dhe më pas kalohet te:

Metoda 2 – Mallra identike

4. Metoda 2 “Mallra identike” bazohet në vlerën e transaksionit të mallrave identike të shitura për eksport në Republikën e Shqipërisë dhe të eksportuara në ose afërsisht në të njëjtën kohë me mallrat që po vlerësohen.

5. Mallra identike janë mallra të prodhuara në të njëjtin vend, të njëjta në çdo aspekt, përfshirë karakteristikat fizike, cilësinë, reputacionin tregtar (marka dhe reputacioni në treg).

6. Nëse nuk zbatohet Metoda 2, duhen argumentuar dhe shënuar në formularin e vlerësimit arsyet në mënyrë të detajuar dhe shteruese dhe më pas kalohet te:

Metoda 3 – Mallra të ngjashme

7. Metoda 3 “Mallra të ngjashme” bazohet në vlerën e transaksionit të mallrave të ngjashme të shitura për eksport në Republikën e Shqipërisë dhe të eksportuara në ose afërsisht në të njëjtën kohë me mallrat që po vlerësohen.

8. Mallrat e ngjashme janë mallra që ndryshojnë në disa aspekte nga mallrat që vlerësohen. Ato duhet të kryejnë të njëjtat funksione, të prodhohen në të njëjtin vend dhe të jenë të këmbyeshme komercialisht me mallrat që vlerësohen.

9. Nëse nuk zbatohet Metoda 3, duhen argumentuar dhe shënuar në formularin e vlerësimit arsyet në mënyrë të detajuar dhe shteruese dhe më pas kalohet te:

Metoda 4 – Metoda deduktive

10. Duke përdorur metodën deduktive, vlera doganore llogaritet në bazë të çmimit për njësi me të cilin shiten mallrat në Republikën e Shqipërisë. Çmimi për njësi i përdorur mund të jetë për mallrat e importuara ose për mallra identike ose të ngjashme të importuara. Ato duhet të shiten në gjendjen siç janë të importuara dhe në sasinë më të madhe të përgjithshme. Blerësi dhe shitësi nuk mund të jenë të lidhur sipas kuptimit të legjislacionit doganor.

11. Çmimit të shitjes në Republikën e Shqipërisë i zbriten:

- a) Kostot direkte dhe indirekte të marketingut të mallrave në fjalë
- b) kostot e zakonshme të transportit dhe sigurimit brënda territorit në RSH
- c) detyrimet doganore dhe taksat e tjera të paguara në RSH për shkak të importimit

12. Çmimi për njësi përcaktohet si çmimi me të cilin shitet numri më i madh i njësive në nivelin e parë tregtar pas importimit në të cilin kryhen shitjet e tilla. Shitjet të jenë kryer në ose rreth kohës së importimit të mallrave që po vlerësohen me këtë metodë, por jo më shumë se 90 ditëve nga data e importimit.

13. Nëse nuk zbatohet Metoda 4, duhen argumentuar dhe shënuar në formularin e vlerësimit arsyet në mënyrë të detajuar dhe shteruese dhe më pas kalohet te:

Metoda 5 – Metoda e kostos së llogaritur

14. Metoda e kostos së llogaritur përdoret kur shitësi është prodhuesi aktual i mallrave dhe mund të japë të gjitha informacionet që lidhen me prodhimin e mallrave të importuara.

15. Vlera doganore përcaktohet duke llogaritur shumën e elementëve të mëposhtëm:

- a) kostoja e materialeve dhe fabrikimit ose përpunimit deri në prodhim e mallrave të importuara.
- b) Kostot direkte apo indirekte të marketingut dhe fitimi
- c) Kosto e transportit dhe siguracionit.

16. Nëse nuk zbatohet Metoda 5, duhen argumentuar dhe shënuar në formularin e vlerësimit arsyet në mënyrë të detajuar dhe shteruese dhe më pas kalohet te:

Metoda 6 – Të dhënat e disponueshme

17. Metoda 6 “Të dhënat e disponueshme” përdoret vetëm kur metodat e tjera nuk mund të aplikohen.

VII. PROCEDURA NË RAST TË DYSHIMEVE TË ARSYESHME

1. Në rastet kur gjatë kontrollit dokumentar ose analizës së riskut krijohen dyshime të arsyeshme mbi saktësinë e vlerës së deklaruar, doganieri i Sektorit Vlerësimi në Qendër ndjek procedurën e verifikimit dhe rivlerësimit në përputhje me legjislacionin doganor në fuqi.

2. Dyshimet e arsyeshme apo indikatorët që mund të evidentojnë një shqyrtim më të thelluar të vlerës doganore, mund të jenë:

- a) çmime dukshëm më të ulëta krahasuar me të dhënat e vlerës në Databazat Kombëtare të Vlerësimit, referuar të njejtës periudhë në të cilën kryhet importi;
- b) dokumentacion i paplotë;
- c) mospërputhje midis dokumenteve;
- d) marrëdhënie midis palëve;
- e) mungesë dokumentacioni financiar;
- f) ndryshime të pajustificuara në deklaratimet historike.

3. Gjatë kësaj procedure, deklaruesit i kërkohet të paraqesë informacion dhe dokumentacion shtesë që mundëson verifikimin e vlerës reale të transaksionit. Nëse pas analizës së informacionit të paraqitur dyshimet mbeten, doganieri mund të refuzojë përdorimin e metodës së vlerës së transaksionit dhe të kalojë në metodat alternative të vlerësimit.

4. Dokumente shtesë që mund të kërkohen nga doganieri:

- a) kontrata tregtare;
- b) katalogë;
- c) çmime reference;
- d) prova bankare;
- e) deklaratime të mëparshme;
- f) dokumente kontabël.

VII. PROCEDURAT QË NDIQEN NGA SEKTORI I VLERËS NË QENDËR (SVQ)

1. Përzgjedhja në kanalin e verdhë

1.1. Nëse deklarata është përzgjedhur në kanalin e "verdhë", kjo do të thotë se ajo deklaratë do t'i nënshtrohet verifikimit dokumentar.

1.2. Sistemi AW i mundëson personelit të SVQ shpërndarjen automatike të deklaratave doganore. Nëse kjo shpërndarje për shkaqe objektive nuk realizohet automatikisht, përgjegjësi i turnit të SVQ, kryen shpërndarjen bazuar në ngarkesën e punës së personelit në varësi.

1.3. Nëse, si rrjedhojë e shpërndarjes automatike të deklaratave doganore, konstatohet që një deklaratë është caktuar gabimisht nga sistemi për t'u procesuar më tej nga SVQ, Përgjegjësi i SVQ kontakton menjëherë në formë elektronike (e-mail), me Përgjegjësin e

Turnit/Zyrës/Sektorit operacional në Degën e Doganës ku është depozituar deklarata doganore në adresën e dedikuar '@dogana.gov.al'/Asycuda World, i cili manualisht duhet të kryejë rishpërndajen bazuar në ngarkesën e punës së personelit në varësi.

1.4. Doganieri i SVQ verifikon nëse:

- a) deklarata është plotësuar në mënyrë korrekte;
- b) është vendosur kodi tarifor i duhur;
- c) përputhet përshkrimi me kodin tarifor;
- d) janë plotësuar korrekt inkotermat;
- e) është plotësuar korrekt dhe i detajuar përshkrimi mallrave në kuadratin 31 të DAV;
- f) është plotësuar korrekt njësia matëse, paketimi;
- g) është bërë ndarja në "bis" e deklaratës kur në faturë ka disa artikuj që klasifikohen në kode të ndryshme apo paketime të ndryshme;
- h) të dhënat e deklaruarra përputhen me ato që përmbajnë dokumentet shoqëruese;
- i) dokumentet shoqëruese i plotësojnë kërkesat e parashikuara nëpërmjet akteve ligjore e nënligjore;

1.5. Më pas vijon me kontrollin për saktësinë e të dhënave që përmban një deklaratë doganore. Gjatë kontrollit të deklaratës, doganieri duhet të marrë në konsideratë:

- a) klasifikimin tarifor;
- b) origjinën;
- c) marrëdhëniet midis palëve;
- d) kushtet e lëvrimit;
- e) mënyrën e pagesës;
- f) ndryshimet e pazakonta të çmimeve;
- g) të dhënat historike të importeve;
- h) historikun e operatorit ekonomik;
- i) informacionet operative dhe databazat referuese.
- j) databaza historike;
- k) informacion nga doganat homologe;
- l) databaza të çmimeve ndërkombëtare;
- m) internet dhe katalogë tregtarë;
- n) profile risku;
- o) informacion operacional.

2. Përzgjedhja në kanal të kuq

2.1. Nëse deklarata përzgjidhet në kanalin e kuq, kjo do të thotë se për atë deklaratë zbatohen fillimisht procedurat që lidhen me verifikimin e gjendjes fizike të mallrave dhe më tej ato që lidhen me verifikimin dokumentar. Sistemi AW i mundëson personelit të Degës Doganore shpërndarjen automatike të deklaratave doganore. Nëse kjo shpërndaje për shkaqe objektive

nuk realizohet automatikisht, Përgjegjësi i Zyrës/Turni/ kryen shpërndarjen bazuar në ngarkesën e punës së personelit në varësi.

2.2. Nëse, si rrjedhojë e shpërndarjes automatike të deklaratave doganore, nga ana e personelit të SVQ apo të Degës Doganore, konstatohet që një deklaratë është caktuar gabimisht nga sistemi për t'u procesuar më tej nga SVQ, Përgjegjësi i SVQ kontakton menjëherë në formë elektronike (e-mail), me Përgjegjësin e Turnit/Zyrës/Sektorit operacional në Degën e Doganës ku është depozituar deklarata doganore, në adresën e dedikuar '@dogana.gov.al'/Asycuda World (apo anasjelltas), i cili manualisht duhet të kryejë rishpërndarjen bazuar në ngarkesën e punës së personelit në varësi.

2.3. Kontrolli fizik kryhet duke zbatuar me rigorozitet procedurat e përcaktuara në Manualin e Kontrollit Fizik.

2.4. Me përfundimin e kontrollit fizik, rezultatet e kontrollit të kryer dhe/ose gjetjet përkatëse përshkruhen në mënyrë të detajuar në Aktin e Kontrollit në AW. Doganieri që kryen kontrollin fizik, me përfundimin e plotësimit të Aktit të Kontrollit, dërgon deklaratën 'në pritje' duke kryer veprimin në sistem 'Re-route to Query'. Vetëm pas këtij veprimi, praktika doganore mund të përpunohet nga doganieri i ngarkuar për verifikimin dokumentar në SVQ. Doganieri i kontrolli fizik në Degë Doganore mbetet në pritje të orientimeve/kërkesave përkatëse nga SVQ.

2.5. Procedurat që ndiqen nga personeli doganor i SVQ, në rastin e deklaratave të përzgjedhura në kanalin e kuq, janë të njëjta me ato të përshkruara në pikën që trajton procedurat për përzgjedhjen në kanalin e verdhë.

2.6. Komunikimi lidhur me orientime/kërkesa të ndryshme që mund të nevojiten nga SVQ me Degën Doganore kryhet nga adresa zyrtare e postës elektronike '@dogana.gov.al'/Asycuda World Mail.

2.7. Në funksion të komunikimit ndërmjet personelit doganor të SVQ dhe Degëve Doganore, në serverin 192.168.1.141 është krijuar një 'dosje' (share folder) me qëllim depozitim të fotove/materialeve nga doganieret e kontrollit fizik të Degëve Doganore. Kjo 'dosje' (share folder) do të popullohet me 'nën-dosje' (subfolder) të emërtuara sipas Degëve/zyrave Doganore ku brenda tyre janë të përcaktuara me 'nën- dosje' (subfolder) muajt dhe datat.

2.8. Të gjitha foto/materialet që depozitohen në to duhet të përmbajnë si emërtesë një format ku të shënohet numri ('R') i deklaratës dhe kur janë më shumë se një foto/materiale për secilën numër ('R') deklaratë (sipas datës përkatëse), të shoqërohen me numra 1, 2, 3 e në vijim. Format i emërtesës është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga të gjitha Degët Doganore.

Për shembull:

Për deklaratën me numër R1024, në 'nën-dosjen' (subfolder) përkatëse sipas datës së regjistrimit të deklarimit AW-s do të vendosen fotot/materialet me emërtesën R1024-1, R1024-2, R1024-3 e kështu me radhë, për aq foto/materiale sa duhen bashkëlidhur.

2.9. Doganierët e kontrollit fizik të Degëve Doganore kanë të drejta vetëm për hedhjen e fotove/materialeve dhe shikimin e tyre, por jo për fshirjen/eliminimin e tyre, ndërsa personeli i SVQ vetëm për shikimin/printimin e tyre.

2.10. Ruajtja e këtyre të dhënave bëhet për një periudhë kohore 120 ditore.

3. Kontrolli mbi klasifikimin tarifor

3.1. Në lidhje me kontrollin e klasifikimit tarifor doganieri i kontrollit dokumentar sigurohet që:

a) Përshkrimi tregtar i mallit t'i korrespondojë përshkrimit të kodit tarifor të deklaruar sipas Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave (NKM). Klasifikimi tarifor duhet të verifikohet nëse është në përputhje me Rregullat e Përgjithshme të Interpretimit, Shënimet e Seksionit dhe Kapitullit përkatës. Në rast se ekzistojnë ende paqartësi në lidhje me klasifikimin tarifor, atëherë duhet të konsultohen Notat Shpjeguese të Sistemit të Harmonizuar të OBD apo të BE.

Për shembull:

- *T'i kushtohet vëmendje pozicioneve "përgjithësuese", emërtimeve të tilla si 'të tjera' – të tjera – të tjera' dhe sidomos në rastet kur niveli tarifor i kodit me përshkrim 'të tjera' është më i ulët se niveli tarifor i kodeve të shifrore të të njëjtit kre të NKM.*
- *T'i kushtohet vëmendje mallrave të cilat janë të përbëra nga pjesë të ndryshme (sete, duzina, komplete) nëse plotësohen kushtet e Rregullit të Përgjithshëm të NKM 3b, që ka të bëjë me klasifikimin e "mallrave të vendosura në grupë për shitje me pakicë".*
- *T'i kushtohet vëmendje klasifikimit të mallrave për të cilat ka udhëzime klasifikimi nga DPD.*

b) Operatori ka aplikuar për Informacion Detyrues Tarifor (ITD) dhe klasifikimi tarifor i dhënë me ITD i korrespondon në çdo detaj mallit të deklaruar. T'i kushtohet vëmendje plotësisht të kodit përkatës shtesë në sistemin AW në rubrikën përkatëse të DAV për ITD e lëshuara. Nëse ka paqartësi për ITD, mund të kërkohet mendim më i specializuar pranë Sektorit të Tarifës me shkresë ose në mënyrë elektronike.

c) Është kyer më parë një verifikim dhe analizë e të njëjtit lloj malli nga Laboratori Doganor, me qëllim përcaktimin dhe klasifikimin tarifor të mallrave.

4. Kontrolli mbi origjinën e mallrave

4.1. Prova e origjinës duhet të jetë lëshuar në momentin e eksportit ose kur eksporti është siguruar. Vërtetimi i origjinës preferenciale është i vlefshëm për katër muaj nga data e lëshimit në palën eksportuese bazuar në Konventën Rajonale për rregullat e origjinës pan-Euro-Mesdhetare si dhe Marrëveshjen e Partneritetit dhe Bashkëpunimit Tregtar me Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandën e Veriut, ose për 10 muaj bazuar në Konventën pan-Euro-Mesdhetare, të rishikuar dhe duhet depozituar brenda këtyre periudhave tek autoritet doganore.

4.2. Formulari i çertifikatës EUR.1 i cili mund të jetë hard-copy ose i lëshuar në mënyrë elektronike duhet të përmbushë kushtet e parashikuara në protokollin përkatës të rregullave të origjinës preferenciale në fuqi.

4.3. Të krahasohen vulat e Çertifikatave të Origjinës EUR.1 (në kutinë nr.11) me specimenet e përcjella nga doganat homologe apo Komisioni Evropian. Në rastin e çertifikatave elektronike të shihet Matriksi i publikuar nga KE në lidhje me shtetet që lëshojnë çertifikata elektronike EUR.1 dhe datën e fillimit të tyre.

4.4. Nëse prova e origjinës është një deklaratë-origjine nga një eksportues i thjeshtë, të verifikohet vlera e produkteve origjinuese pasi nuk duhet t'i kalojë 6'000 (gjashtë mijë) Euro.

4.5. Nëse deklarata-origjinë është dhënë nga një eksportues i autorizuar nga autoritetet doganore, të verifikohet formati i numrit të autorizimit me modelet e përcjella nga doganat homologe apo Komisioni Evropian.

4.6. Në rastet e deklaratave-origjinë të lëshuara nga eksportuesit, duhet të sigurohet që teksti i deklarimit të origjinës, në faturë apo në ndonjë dokument tjetër tregtar, të jetë sipas aneksit përkatës të protokollit të rregullave të origjinës, si dhe të verifikohet firma origjinale e eksportuesit pasi duhet të jetë e shkruar me dorë (përjashtim nga firma origjinale bën eksportuesi i miratuar, i cili mund të mos i nënshkruajë këto deklarata).

4.7. Nëse operatori ekonomik ka në praktikën doganore një vendim Informacioni Detyrues të Origjinës (IDO) të plotësohet kodi shtesë përkatës në systemin Asycuda World në rubrikën përkatëse të DAV.

4.8. Nëse ka dyshime në lidhje me autenticitetin e provës së origjinës apo origjinën e mallrave të mbuluara prej tyre, të dërgohet prova përkatëse pranë Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës me qëllim nisjen e procedurës së verifikimit pranë doganës përkatëse homologe. Nëse dyshimet janë për autenticitetin dërgohet prova e origjinës origjinale.

5. Verifikime mbi marrëdhëniet midis palëve

5.1. Duhet të verifikohet marrëdhënia midis palëve, blerësit dhe shitësit, për të vlerësuar nëse:

- a) palët janë të lidhura;
- b) ekziston ndikim në çmim;

- c) aplikohet transferim çmimi;
- d) ekzistojnë marrëveshje ekskluzive.

6. Kushtet e lëvrimit

INKOTERM

Në tabelën në vijim janë paraqitura disa “Incoterm-a” kryesore të cilat hasen më shpesh gjatë tregtisë ndërkombëtare.

Incoterm	Përshkrimi i Incoterm	Përshkrimi në Shqip	Vlera e përfshirë në faturë	Mënyra e transportit
EXW	Ex Works	Mallrat vihen në dispozicion te shitësi	Vetëm vlera e mallrave	Të gjitha mënyrat
FCA	Free Carrier	Dorëzim te transportuesi i caktuar	Mall + dorëzim te transportuesi	Të gjitha mënyrat
CPT	Carriage Paid To	Transporti paguar deri në pikën hyrëse	Mall + transport	Të gjitha mënyrat
CIP	Carriage and Insurance Paid to	Transport dhe sigurim të paguara deri ne pikën hyrëse	Mall + transport + sigurim	Të gjitha mënyrat
DAP	Delivered At Place	Dorëzim në vendin e caktuar (ambjentet e blerësit)	Mall + transport deri në destinacion	Të gjitha mënyrat
DPU	Delivered at Place Unloaded	Dorëzim dhe shkarkim në ambjentet e blerësit	Mall + transport + shkarkim	Të gjitha mënyrat
DDP	Delivered Duty Paid	Dorëzim në ambjentet e blerësit dhe detyrime të paguara	Mall + të gjitha kostot dhe taksat e paguara	Të gjitha mënyrat
FAS	Free Alongside Ship	Dorëzim pranë anijes në port	Mall + transport deri në port (pa ngarkuar në anije)	Detar
FOB	Free On Board	Dorëzim në bordin e anijes (dhe ngarkimi)	Mall + transport dhe ngarkim në anije	Detar
CFR	Cost and Freight	Kosto dhe transport deri në portin e destinacionit	Mall + transport detar	Detar
CIF	Cost Insurance and Freight	Kosto, sigurim dhe transport deri në portin e destinacionit	Mall + sigurim + transport detar	Detar

Siç shihet, për çdo inkoterm në kollonën “vlera e përfshirë në faturë” jepet vlera e shpenzimeve të transportit apo siguracionit që përfshihet në faturën që shoqëron mallrat. Sipas inkoterm, duhet të shtohet apo të zbritet vlera e asaj pjese të shpenzimit të transportit apo siguracionit (nëse ka) që nuk është e përfshirë në faturë.

Shembuj:

1. Kur fatura ka inkoterm FOB, do të thotë se në faturë është e përfshirë krahas vlerës së mallrave dhe vlera e transportit deri në anije dhe ngarkimi në anijen e transportit për në RSh, por nuk është përfshirë vlera e transportit me anije deri në portin hyres në RSh. Vlera doganore duhet të përbëhet nga vlera e faturës FOB duke i shtuar vlerën e transportit me anije, si dhe vlerën e siguracionit sëse ka.
2. Nëse fatura ka incoterm DAP, do të thotë se në faturë është përfshirë krahas vlerës së mallrave dhe vlera e transportit deri në ambjentet e operatorit (blerësit). Kjo tregon se në faturë përfshihet dhe vlera e transportit nga pika kufitare hyrëse në RSH deri në ambjentet e operatorit, vlerë e cila nuk duhet të përfshihet në vlerën doganore të mallrave pasi është transport i brëndshëm. Kjo pjesë e vlerës së transportit duhet të zbritet nga vlera e faturës DAP, pasi nuk është pjesë e vlerës doganore.

7. Licence, leje, autorizime, etj. (në rast se importi i mallrave kushtëzohet prej tyre):

7.1. Në rast se importimi i mallrave kërkon plotësimin e kushteve të veçanta (licenca, leje, autorizime, ndalime, kufizime), këto kërkesa verifikohen paraprakisht nga doganieri i SVQ.

8. Kontrolli i dokumentacionit

8.1. Dokumentet bazë për kontroll janë:

- a) Fatura tregtare;
- b) Kontrata;
- c) Packing list;
- d) Dokumenti i transportit;
- e) Dokumentet bankare;
- f) Certifikata e origjinës;
- g) Siguracioni;
- h) Licencat/autorizimet.

8.2. Në lidhje me kontrollin e faturës, doganieri duhet të verifikojë:

- a) numrin e faturës;
- b) datën;
- c) monedhën;
- d) inkoterm;
- e) përshkrimin e mallrave;
- f) sasinë;
- g) çmimin për njësi;
- h) totalin;
- i) nënshkrimin dhe vulën;
- j) përputhjen me dokumentet e tjera.

8.3. Në lidhje me kontrollin e dokumenteve të transportit duhet të verifikohet:

- a) transportuesi;

- b) itinerari;
- c) pesha;
- d) numri i kontejnerit;
- e) data e ngarkimit;
- f) përputhja me faturën dhe packing list.

9. Kontrolli dhe shqyrtimi i vlerës doganore

9.1. Në lidhje me kontrollin dhe shqyrtimin e vlerës doganore, doganieri i kontrollit dokumentar sigurohet që:

- a) Deklarimi doganor përputhet me të dhënat dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur;

Për shembull:

- *Vlerat e faturave shoqëruese të blerjes janë të njëjta me ato të deklaruar në DAV;*
 - *Monedha e deklaruar në DAV përkon me atë të shprehur në faturat shoqëruese;*
 - *Vlera e treguar në faturat shoqëruese është në përputhje me urdhrat e blerjes, kontratat, korrespondencat, etj. T'i kushtohet vëmendje nëse ekzistojnë reduktime ose kompensime në faturat e blejes, si pasojë e transaksioneve të tjera;*
 - *Kushti i lëvrimit të mallrave dhe mënyra e pagesës të deklaruar në DAV, përputhet me dokumentacionin e mallrave;*
- b) Rubrikat përkatëse të DAV-it janë të plotësuara në mënyrë korrekte dhe pa mangësi;
 - c) Referencat (numër/datë) dhe kodifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur DAV pasqyrohet në mënyrë korrekte;
 - d) Fatura që shoqëron mallrat përmban elementët kryesorë për kryejën e vlerësimit doganor, të tilla si: numri i artikujve, sasia, mimi për njësi, numri, data, përshkrimi i mallit, kushti i lëvrimit të mallrave;

9.2. Kur doganieri i SVQ, mbështetur në analizën e riskut, ka dyshime të arsyeshme se vlera e deklaruar e transaksionit nuk përfaqëson shumën totale të paguar ose të pagueshme, siç referohet në pikën I, të nenit 66, të Kodit, mund të kërkojë nga deklaruesi të paraqesë informacione shtesë (në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor dhe Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor dhe akteve nënligjore për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore) dhe deklaruesi është i detyruar që të japë informacion dhe dokumente shtesë lidhur me:

- a) vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura;
- b) informacion ose dokumente shtesë, të nevojshme, për përcaktimin e vlerës doganore të mallrave.

9.3. Në çdo rast, informacioni shtesë duhet të shërbejë vetëm për qartësimin e deklarimit fillestar.

9.4. Në qoftë se përsëri mbeten dyshime, doganieri i SVQ mund të vendosë që vlera e mallit nuk mund të përcaktohet në përputhje me pikën 1, të nenit 66, të Kodit. Doganieri i SVQ, mbështetur në nenin 7.3, të Marrëveshjes për Zbatimin e nenit 7, të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë (GATT 1994), informon deklaruesin për Formularin e Vlerësimit. Formular i Vlerësimit plotësohet sipas Aneksit I, bashkëngjitur këtij udhëzimi dhe duhet të sqarojë dyshimet e arsyeshme, rivlerësimin dhe metodën e vlerësimit të përdorur për llogaritjen e vlerës doganore të mallit të importuar. Ky formular bëhet pjesë e deklaratës doganore duke iu bashkëlidhur dokumentave të tjera të praktikës doganore. Në versionin elektronik në AW plotësohen referencat përkatëse për dokumentin me kodin 903.

9.5. Njëkohësisht, në të gjitha rastet e rivlerësimit, nga ana e doganierit të kontrollit dokumentar do të ndërhyhet në rubriken 43 të DAV-it për metodën e vlerësimit doganor si dhe në rubrikën 45 të DAV-it me koeficientin e ri të vlerës së mallit të rivlerësuar. Në këtë rast, krijohet një version i ri i deklaratës, të cilin sistemi e ruan së bashku me deklaratën origjinale.

9.6. Formulari i Vlerësimit i njoftohet, në formë elektronike (e-mail), deklaruesit (në adresën e depozituar pranë autoriteteve doganore) dhe Degës Doganore (Përgjegjës Zyre/Turni /Sektori, në adresën zyrtare '@dogana.gov.al'/Asycuda World Mail) ku është depozituar deklarata doganore.

9.7. Brenda 10 ditëve nga informimi, deklaruesi mundet të ankohet me shkrim ndaj formularit të vlerësimit pranë degës doganore ku është depozituar deklarata. Dega Doganore komunikon në formë elektronike (e-mail), me personelin e SVQ në adresën e dedikuar '@dogana.gov.al'/Asycuda World nëse nevojiten sqarime të mëtejshme në lidhje me Formularin e Vlerësimit. Vendimi i arsyetuar i Kryetarit të Degës Doganore i komunikohet me shkrim deklaruesit brenda 5 ditëve nga depozitimi i ankimit. Kundër vendimit, personit të interesuar i lind e drejta e ankimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. Në këtë rast, nenet 281 dhe 282, të Kodit, aplikohen *mutatis mutandis*.

9.8. Nëse gjendja e llogarisë nuk mbulon ndryshimet e bëra lajmërohet deklaruesi për të bërë pagesat përkatëse duke shtuar shumën korresponduese në llogarinë parapaguese.

9.9. Vetëm pasi në sistem të jenë reflektuar dhe pranuar ndryshimet e mësipërme, Përgjegjësi i turnit në SVQ miraton çlirimin për konsum të mallrave duke kryer veprimet përkatëse në sistemin AW, deklarata konsiderohet e pranuar dhe sistemi cakton automatikisht një numër serial që fillon me 'P'. Ky numër (numri i pranimi) do të shfaqet në rubrikën 'B' të DAV.

9.10. Doganieri në SVQ, mund të ndryshojë/amendojë deklaratën doganore vetëm pas një Vendimi të Kryetarit të Degës Doganore (që është akt administrativ që krijon detyrime) mbi një akt apo procesverbal konstatimi.

9.11. Përgjegjësi i Turnit/Zyrës/Sektorit operacional në Degën e Doganës ku është depozituar deklarata doganore, pas marrjes së numrit serial 'P' dhe 'M', kryen në sistem veprimet e nevojshme për çlirimin e mallrave.

VIII. KONSTATIMI I SHKELJEVE DOGANORE

1. Nëse nga verifikimet që kryen doganieri i verifikimit dokumentar në SVQ apo doganieri i kontrollit fizik në Degën Doganore ku është depozituar deklarata doganore, gjen mospërputhje apo parregullsi (shkelje të dispozitave të Kodit Doganor dhe akteve nënligjore), rezultatet e verifikimit/kontrollit të kryer dhe/ose gjetjet përkatëse përshkruhen në mënyrë të detajuar në Aktin e Kontrollit në AW.

2. Në çdo rast, plotësohet edhe Formular i Vlerësimit nga doganieri i SVQ sipas Aneksit nr.1 bashkëngjitur këtij udhëzimi, si dhe informohet deklaruesi dhe Dega Doganore për Formularin e Vlerësimit. Formular i Vlerësimit i njoftohet në formë elektronike (e-mail), deklaruesit (në adresën e depozituar pranë autoriteteve doganore) dhe Degës Doganore (Përgjegjës Zyre/Turni/Sektori dhe doganierit të kontrollit fizik, në adresën zyrtare '@dogana.gov.al'/Asycuda World Mail) ku është depozituar deklarata doganore.

3. Ky formular bëhet pjesë e deklaratës doganore duke iu bashkëlidhur dokumentave të tjera të praktikës doganore. Në versionin elektronik në AW plotësohen referencat përkatëse për dokumentin me kodin 903 (kodi dokumentit). Në këtë rast krijohet një version i ri i deklaratës, të cilin sistemi e ruan së bashku me deklaratën origjinale.

4. Në vijim, Përgjegjësi i Zyrës/Turni/Sektorit dhe doganieri i kontrollit fizik, duhet të plotësojnë edhe Procesverbalin e Verifikimit të Shkeljeve (bazuar në Formularin e Vlerësimit dhe Aktin e Kontrollit në AW), sipas Manualit Udhëzues "Mbi Zbatimin e Dispozitave Lidhur me Shkeljet në Fushën Doganore dhe Akcizës" miratuar me Urdhrin Nr.05 të Drejtorit të Përgjithshëm datë 12.01.2024. Procedurat në vijim, pas hartimit të Procesverbalit të Verifikimit të Shkeljeve përcaktohen në udhëzimin e sipërcituar. Në rastin e aplikimit të nënshkrimit elektronik, Procesverbali i Verifikimit të Shkeljeve do të hartohet dhe nënshkruhet nga struktura konstatuese e shkeljes doganore (SVQ apo Degë Doganore).

5. Vendimi i arsyetuar i kryetarit të Degës Doganore merret në përputhje me nenin 276 të Kodit Doganor. Në vendimin e kryetarit të Degës Doganore, të mbështetur në procesverbal, aktkonstatimi, etj, duhet të theksohet edhe ndryshimi/amendimi i deklartës doganore në bazë të gjetjeve faktike sasi, peshë, natyrë, klasifikim, origjinë, vlerësim, apo të tjera.

Ndaj këtij vendimi, lind e drejta e ankimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave në përputhje me nenet 281 dhe 282, të Kodit Doganor.

6. Vetëm pasi në sistem të jenë reflektuar dhe pranuar ndryshimet e mësipërme, Përgjegjësi i Turnit në SVQ miraton çlirimin për konsum të mallrave duke kryer veprimet përkatëse në sistemin AW, deklarata konsiderohet e pranuar dhe sistemi cakton automatikisht një numër serial që fillon me 'P'. Ky numër (numri i pranimit) do të shfaqet në rubrikën 'B' të DAV.

7. Përgjegjësi i Turnit/Zyrës/Sektorit operacional në Degën e Doganës ku është depozituar deklarata doganore, pas marrjes së numrit serial 'P' dhe 'M', kryen veprime në sistem.

8. Doganieri i SVQ, jep ndihmesë në përcaktimin e vlerës së mallrave që do rivlerësohen për efekt penalitetesh mbështetur në akt-konstatime, të përpiluara nga struktura në DPD apo në bashkëpunim me to, përpara marrjes së vendimit nga kryetari i degës doganore.

IX. ETIKA DHE INTEGRITETI

1. Punonjësi doganor duhet të ushtrojë detyrën në përputhje me Urdhrin Nr. 90, datë 18.11.2014 të Ministrit të Financave "Për miratimin e Kodit të Etikës në Shërbimin Doganor Shqiptar", dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke:

- a) Ruajtur konfidencialitetin;
- b) Shmangur konfliktin e interesit;
- c) Dokumentuar çdo vendim;
- d) Respektuar transparencën;
- e) Garantuar gjurmueshmërinë administrative.

X. BASHKËPUNIMI NDËRMJET STRUKTURAVE

1. Strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe degët doganore bashkëpunojnë ngushtësisht me Drejtorinë e Vlerësimit në Qendër duke bërë të mundur sigurimin e të gjithë informacionit të nevojshëm, në drejtim të realizimit të detyrave funksionale dhe marrjes së vendimeve të drejta.

2. Gjatë zbatimit të detyrave funksionale dhe procedurave standarde të operimit, personeli doganor i SVQ, bashkëpunon dhe ndërvepron ngushtësisht, në kohë reale, me strukturat doganore nëpër Degë Doganore, si dhe strukturat operative të DPD-së, të cilat kanë detyrim për t'u përgjigjur menjëherë, brenda afateve të kërkuara.

XI. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Udhëzimi Nr.05 Datë 26.01.2018 "Mbi Procedurat Standarte të funksionimit të Sektorit të Vlerësimit Qendror dhe Sektorit të Kontrollit Aposterior Operativ", i Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, shfuqizohet.

2. Ngarkohen me zbatimin e këtij udhëzimi të gjitha strukturat e përmendura në këtë udhëzim.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Besmir Beja



FORMULAR MBI VLERËSIMIN DOGANOR

Sektori i Vlerësimit në Qendër

Tirane SVQ

I. Të dhëna të përgjithshme:

Punonjësi	Importuesi	Përfaqësuesi/Deklaruesi	DAV	

II. Informacion i detajuar për artikujt që rivlerësohen:

Artikujt ose Transporti	Kodi NK	Kushti i Lëvrimit	Origjinë	Njësia	Çmimi i Deklaruar	Monedha	Çmimi Aplikuar

III. SHQYRTIMI DHE ANALIZA

Nga verifikimi i deklarimit doganor dhe dokumentacionit bashkëngjitur, u konstatua se nuk plotësohen kriteret ligjore që mundësojnë aplikimin e metodës kryesore të vlerësimit sipas vlerës së transaksionit të deklaruar, për një ose disa nga arësyet si më poshtë:

	PO	JO
■ çmime dukshëm më të ulëta se ato të databazave;	☐	☐
■ dokumentacion të paplotë	☐	☐
■ mospërputhje midis dokumenteve	☐	☐
■ marrëdhënie midis palëve	☐	☐
■ mungesë dokumentacioni financiar	☐	☐
■ ndryshime të pajustificuara në deklarimet historike	☐	☐

Nga sa më sipër vlerësimi do të kryhet sipas metodave dytësore të vlerësimit, konkretisht:

Metoda 2 e vlerësimit: Metoda e “mallrave identike”

	PO	JO
■ Deklarate R____, Dt _____	☐	☐
■ Vëndi eksportues i njëjtë	☐	☐
■ Marka e njëjtë	☐	☐
■ Te tjera		

Metoda 3 e vleresimit: Mallra të ngjashme

- Mallra të Ddeklarate R____, Dt _____
- Vëndi eksportues i njëjtë
- Mallra të këmbyeshtëm komercialisht
- Kryejnë të njëjtat funksione
- Te tjera

PO

☐
☐
☐
☐

JO

☐
☐
☐
☐**Metoda 4 e vleresimit: Metoda deduktive**

- Fatura shitjeje në tregun shqiptar
- Librat e shitjeve dhe deklarimet fiskale
- Marzhi i fitimit të importuesit (zbritet)
- Shpenzimet e transportit, magazinimit pas importit (zbritet)
- Te tjera

PO

☐
☐
☐
☐

JO

☐
☐
☐
☐**Metoda 5 e vleresimit: Metoda e kostos së llogaritur:**

- Koston e lëndëve të para
- Koston e punës dhe shpenzimet e përgjithshme
- Fitimin dhe shpenzimet administrative të prodhuesit
- Deklarim ose konfirmim i prodhuesit mbi informacionin e mësipërm
- Te tjera

PO

☐
☐
☐
☐

JO

☐
☐
☐
☐**Metoda 6 e vleresimit**

Nëse përdoret kjo metodë do të thotë se nuk është gjetur përdorim për asnjë nga metodat 1 deri në 5. Kjo metodë do të bazohet në raste krahasimore të gjetura në Site-t e parashikuara në pikën 15 dhe në përcaktimet e pikës 16 dhe 17 të udhëzimit 03, datë 23.01.2018- të ndryshuar me udhëzimin nr. 26, datë 17.12.2025. Gjithashtu, do të bazohet dhe në Dosjen e të Dhënave të Disponueshme.

VENDIMMARRJA:**Metoda 2**☐**Metoda 3**☐**Metoda 4**☐**Metoda 5**☐**Metoda 6**☐**Argumentimi i plotë për procesin dhe mënyrën e vlerësimit doganor:**

Në përputhje me Kodin Doganor dhe VKM 651, datë 10.11.2017, si dhe udhëzimet për zbatimin praktik të këtyre akteve, për aplikimin e metodave të vlerësimit doganor të mallrave;

Nisur nga kërkesa/mesazhi e/i kriterit të verifikimit të deklaratës doganore për mallrat sipas kodit tarifor në deklarim, u konstatua se:

Kriteret për pranimin e vlerës së transaksionit të deklaruar në import nuk plotësohen.

Në këto kushte, u procedua me rivlerësim të vlerës doganore të mallrave sipas metodave dytësore duke

ndjekur radhën e përshkruar në përcaktimet e Kodit Doganor për këtë qëllim.

Shpenzimet e transportit llogariten sipas udhëzimeve dhe shkresës së DPD-së me nr. prot. 6142/4 datë 15.05.2018.

Për sa më sipër, bashkelidhur dokumentacioni plotësues.

Vlerësimi për qëllime doganore i mallit/mallrave të deklaruar sipas metodës dytësore të vlerësimit sjell detyrimin e importuesit për të paguar;

Shumën e detyrimit shtesë në masën: _____ Lekë

**Për SVQ
Punonjësi:**

**Për importuesin
Deklaruesi/Perfaqesuesi:**
